



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 838 Prot.

Tiranë, më datë 21.08.2020

VENDIM

Nr. 295, datë 21.08.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të projektit dhe raportit të vëzhgimit arkeologjik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.08.2020,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Ndryshime në projekt për objektin e miratuar me vendim të KRRT-së Nr. 03, datë 09.07.2010 të Bashkisë Durrës, Kompleks Vila banimi 2 kat+1kat nën tokë, Braka Residences Diamond Hill”, kërkesë e “Braka Construction” sh.p.k. dhe koncepti i sondazheve arkeologjike realizuar nga personi i licencuar në arkeologji z. Skënder Muçaj;
    - Plotësim me informacionin e plotë dhe të qartë të projektit fillestar dhe të ndryshuar;
    - Plotësim me dokumentacion dhe pozicionimin në raport me zonën arkeologjike “B” të qytetit të Durrësit;
  2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
  3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Arta DOLLANI

KRYETAR

Eva MARGARITI

